

*Qendra e artit-* është e pajisur me materiale të llojllojshëm që mundësojnë krijimtarinë artistike nga ana e fëmijëve, materialet në rafte janë të arritshme nga fëmijët, ata mund të shërbehen me to dhe ti vendosin gjerat tjera përsëri në vendin e tij. Qendra është e pajisur me lloje të ndryshme të ngjyrave, letër, materiale kolazhi, materiale të natyrës etj. Vendosja e disa përparëse tek kavaleta ndihmon fëmijët që në fillim të punës me ngjyra të vendosin përparëset. Fëmijët mund të zhvillojnë një varg aktiviteteesh artistike që kanë të bëjnë me stampimin, ngjyrosje me gisht, piktura me njolla boje, brumë për të luajtur etj.

*Qendra e blloqeve ndërtimore-* blloqet ndërtuese janë mjaft tërheqëse dhe atraktive për fëmijët, pothuajse të gjithë fëmijët kanë dëshirë të luajnë me blloqe. Përfitimi i lojës me blloqe është i ndërlidhur pothuajse me të gjitha fushat zhvillimore. Gjatë këtyre lojërave fëmijët zhvillohen në aspektin social duke ndarë dhe shkëmbyer materialet në mes vete fëmijët.

*Qendra e lojës dramatike-* duhet të vendoset përbrinjë qendrës së blloqeve meqë fëmijët shpesh here gjatë lojës kombinojnë aktivitetet dhe materialet e ndryshme të cila janë sjellë prej disa prindërve. Po ashtu që te dyja qendrat janë shumë të zhurmshme,.

*Qendra e shkencës-* në qendrën e shkencës fëmijët kanë mundësi të eksplorojnë me materiale të ndryshme, të kuptojnë marrëdhënien në mes të dukurive, eksperimentojnë me produkte nga jeta e përditshme, eksplorojnë natyrën duke e bërë kështu institucionin parashkollor vendin ku fëmijët kanë mundësi të bëjnë ëndrrat e tyre realitet.

*Qendra e gatimit* – kuzhina për fëmijët është një vend magjikë në të cilin gjithmonë ka diçka për të bërë. Fëmijët përmes lojës mund të eksperimentojnë me mjetet dhe materiale ushqimore duke mësuar për vetitë e tyre, karakteristika, etj. Një recetë e thjeshtë biskotash mund ta shndërrojë këtë ditë me ditën më të veçantë të fëmijës në institucion parashkollor. Gjatë përgatitjes së biskotave fëmija natyrshëm zhvillohet në të gjitha fushat zhvillimore e jo vetëm në atë të kuzhinës në këtë rast.

*Qendra e muzikës-* muzika zakonisht përdoret për të qetësuar, rehatuar, zvarritur dhe ndriçuar mendjet e fëmijëve (1997). Muzika ndikon në të gjitha fushat zhvillimore duke filluar nga ndikimi në fushën e zhvillimit emocional, shoqëror, zhvillimin e gjuhës, zhvillimin intelektual dhe zhvillimin motorikë. Edukatorët duhet edhe të kenë kreativitet

të jenë në gjendje të vlerësojë. Ndërtimi i maketeve me material recikluese dhuron shumë kënaqësi për fëmijët.

*Qendra e rërës dhe ujit*- është njëra nga qendrat e cila gjendet edhe në hapësirat e brendshme të kopshtit edhe në hapësirat e jashtme të tij. Qendra e rërës dhe ujit krijon mundësi për ndërveprim me objektet përreth, përmes mbushjes dhe zbrazjes fëmijët kuptojnë raportet e kundërta, etj.

*Mjedisi natyror*- është hapësira jashtë objektit e cila poashtu duhet të jetë e organizuar, të ketë pajisje dhe rekuizita të cilat i ndihmojnë fëmijët të fillojnë të praktikojnë aktivitete të ndryshme sportive. Në një kënd është e vendosur qendra e rërës dhe ujit, një pjesë është e gjelbëruar, ndërsa në një kënd tjetër janë të vendosura lodrat për fëmijë. Fëmijët po ashtu mund të observojnë mjedisin e jashtëm dhe më pastaj me materialet e mblodhura në qendrën e artit mund të ndërtojnë një kolazh dhe në qendrën e shkencës të ndajnë me të tjerët zbulimin e të tjerëve.

Prindërit paraqesin një nga shtyllat e forta në të cilat mbështetet kjo metodologji, andaj ata duhet të jenë pjesë e të gjitha proceseve që zhvillohen në institucion parashkollor, duke siguruar një partneritet gjithëpërfshirës që ka për bazë interesat më të larta të fëmijës.

Ju mund të kërkoni për më shumë të dhëna në burimet elektronike si:  
<https://www.issa.nl/>  
<http://kec-ks.org/trainimet/>

Përveç qasjeve metodologjike të cilat janë shtjelluar më në hollësi në varësi të nevojave të fëmijëve, përgatitjes profesionale dhe trajnimeve të ndjekura nga edukatorët/ët mund të përdorin edhe qasje të tjera metodologjike si psh. Majeutika edukative, Waldorf, dhe metodologji të tjera të cilat në vitet në vazhdim do të jenë pjesë e programeve të akredituara që ofrohen në vendin tonë.


## KAPITULLI V

### Planifikimi dhe vlerësimi i të arriturave tek fëmijët

Një ndër detyrat më të rëndësishme të edukatoreve është planifikimi i aktiviteteve që do të zhvillohen me fëmijët si dhe matja e të arriturave të fëmijëve përgjatë periudhave të caktuara, të cilat fëmijët mund t'i mbërrijnë përgjatë aktiviteteve. E tërë puna e edukatoreve me fëmijët ka për qëllim që përmes lojës dhe aktiviteteve të tjera të planifikuara dhe organizuara të arrijnë që fëmijët në mosha të caktuara të arrijnë rezultatet e parapara për kompetenca, përmes së cilave fëmijët zhvillojnë edhe njohuritë dhe shkathtësitë edhe për fusha të caktuara.

#### *Procesi ciklik i planifikimit*

Figura. 2. Procesi ciklik i planifikimit<sup>18</sup>



<sup>18</sup> *Planifikimi* është proces i vazhdueshëm, i cili ka për qëllim të sigurojë dhe lehtësoj realizimin e veprimtarisë e cila zhvillohet në institucione parashkollore. Bazuar në qasjen e caktuar metodologjike dhe duke pasur parasysh të gjitha komponentet përbërse sikurse: planifikimin e temës/projektit/ aktiviteteve, përgatitjen e mjedisit, sigurimin e burimeve dhe materialeve të nevojshme dhe përfshirjen e familjes, planifikimi, mundëson që faza e realizimit të jetë më mirë e organizuar, më cilësore dhe efektive. Rutina

## *Planifikimi*

Përpara se të fillohet puna me fëmijët e grup-moshave 0-5 vjeç, edukatorët/ët duhet të kenë vëmendjen e plotë në atë se çfarë aktivitete kanë planifikuar të zhvillojnë me fëmijët gjatë një dite, javë, muaji dhe si do të realizohen ato aktivitete përgjatë këtyre periudhave kalendarike. Sa më i mirë të jetë planifikimi i punës së edukatorëve aq më shumë rezultate do të arrihen në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.

Gjatë planifikimit, edukatorët/ët duhet të kenë fokusin në rezultatet për kompetenca të cilët fëmijët duhet t'i arrijnë në një periudhë kohore të caktuar. Të gjitha temat të cilat edukatorja/i planifikon t'i realizojë me fëmijët duhet të kenë një qëllim të caktuar se pse fëmijët duhet të përfshihen në aktivitetin konkret. Gjithashtu edukatorja/i duhet ta kenë të qartë se çfarë do të përfitojnë fëmijët përmes aktivitetit konkret si dhe duhet të sigurohet që aktivitetet që po zhvillohen kanë koncepte gjithëpërfshirëse zhvillimore dhe edukative.

---

ditore duhet të jetë e planifikuar dhe e strukturuar në detaje në mënyrë që realizimi të jetë më i lehtë dhe i parashikueshëm.

*Realizimi* përfshin pjesën ku fëmijët i ekspozohen lojës, aktiviteteve dhe veprimtarive tjera të planifikuara. Realizimi i lojës, aktiviteteve dhe veprimtarive zhvillohet përgjatë tërë qëndrimit ditor të fëmijës në institucion parashkollor duke krijuar mundësi për aktivitete me tërë grupin, aktivitete me grupe të vogla dhe aktivitete individuale.

*Vëzhgimi* ka të bëjë me vëzhgimin e vazhdueshëm të edukatorit/es përmes teknikave të ndryshme të vëzhgimit me qëllim që të sigurohet që aktivitetet e zhvilluara janë në përputhje me nevojat e fëmijëve, i përmbushin kërkesat që ata kanë, ndikimin e lojrave tek fëmijët, arritshmërinë e tyre, etj. Vëzhgimi është proces i cili krahas realizimit siguron që në vazhdimësi të përmirësohet cilësia e shërbimeve të ofruara, përmes përmirësimeve të vazhdueshme në organizimin e jetës institucionale.

*Reflektimi* është njëra ndër fazat e cila duhet të jetë pjesë e pandashme e gjithë procesit në mënyrë që të sigurohet një ngritje e vazhdueshme e cilësisë. Reflektimi i mundëson secilit edukator të analizojë realizimin ditor, të analizojë angazhimin e fëmijëve, të kuptojë si si ka frymuar jeta në institucion përgjatë ditës dhe në këtë mënyrë përmes reflektive të vazhdueshme edukatori/ja ka mundësi që të bëjë ndryshimet e nevojshme në planifikimet e ardhshme në mënyrë që puna e saj të jetë sa më cilësore dhe në harmoni me nevojat, kërkesat dhe interesat e fëmijëve.

Për të qenë sa më të suksesshëm në punë edukatorja/i duhet që të ketë një planifikim të përgjithshëm se çfarë do të punojë me fëmijët e grup-moshave të caktuara gjatë gjithë vitit. Në këtë mënyrë është e domosdoshme që të përpilohet një plan vjetor, në të cilën do të përcaktohet fokusi i edukatores/it për të ndihmuar fëmijët që të zhvillohen dhe edukohen në përgjithësi. Të sigurohen se aktivitetet të cilat do të planifikohen e përfshijnë zhvillimin e çdo kompetencë të paraparë me Kornizën kurrikulare si dhe përmbushjen e çdo rezultati për kompetencë të përcaktuar me kurrikulën bërthamë për moshat 0-5 vjeç.

Për të pasur më të lehtë planifikimin edukatorja duhet të përcaktojë temat mujore, përmes së cilës pastaj do të ndërtoj temën javore dhe atë ditore. Përpara se të përcaktohen temat mujore, edukatorja/i duhet të ketë parasysh disa faktorë të cilët duhet të ndërliohen patjetër në planifikimin e aktiviteteve, pasi që zhvillimi dhe të nxënit e fëmijëve duhet të jenë në përshtatje me rrjedhën normale të vet jetës që fëmija e bën në përditshmërinë e tij/saj. Për këtë arsye në periudhën e përpilimit të planit vjetor është e domosdoshme që edukatorja/i të merr parasysh periudhën e stinëve dhe çfarë është karakteristike për stinën (në produktet ushqimore të cilat rriten në atë periudhë, veshjet të cilat vishen në atë periudhë, punët të cilat mund të bëhen gjatë asaj periudhe etj), festave vendore (cilat janë karakteristikat e festave, çfarë përfshihet në traditat komëtare rreth festave të caktuara, trashëgiminë kulturore, muzika, instrumentet muzikore, bimët dhe lulet në përgjithësi, etj), ditëve të veçanta të cilat u kushtohet rëndësi në gjithë vendet e botës p.sh dita e tokës, dita e librit etj (pse duhet të kujdesemi për ambientin, ujin, ushqimet, kafshët dhe shpezët, pse janë krijuar librat, përgatitja dhe zhvillimi i një drame etj).

Të gjitha temat duhet të kenë qasje integritit ndër-fushor (ndërlidhja e fushave në një temë të caktuar) dhe të japin një perspektivë më të gjërë fëmijëve përmes aktiviteteve të ndryshme.

Përveç temave edukatorja/i duhet të jetë i/e vëmendshme dhe të sigurohet që të përfshihen të gjitha rezultatet e kompetencave, pasi që arritja e tyre nënkupton zhvillim holistik (i përgjithshëm i fëmijës).

Planifikimet vjetore, edukatorja/i duhet t'i zbërthej në planifikime mujore, duke i përcaktuar temat kryesore të çdo jave, të cilat do të ndërliohen me temën mujore. Edhe

përcaktimi i temave kryesore për javë, duhet të ketë qasje integrale ndërfushore, në mënyrë që zhvillimi i aktiviteteve edukative të jetë sa më i natyrshëm për fëmijët.

Në fund fare edukatorja/i duhet që temat javore t'i zbërthejë në tema ditore, përmes së cilave edukatorja/i i planifikon në hollësi aktivitetet, mënyrën se si do të zhvillohen aktivitetet, si do të përfshihen fëmijët në aktivitete, në çfarë mjedisi do të zhvillohen aktivitetet, kush do të përfshihen në ato aktivitete (prindërit, komuniteti etj), çfarë mjetesh dhe materialesh do të nevojiten për zhvillimin e aktiviteteve, çfarë qasjesh metodologjike do të aplikohet gjatë realizimit të aktiviteteve (nëse fëmijët do të përfshihen në projekte të përbashkëta etj).

Në planifikimet ditore edukatorja/i qartë e përcakton se cilat janë rezultatet e të nxënit për aktivitetin ditor e cila duhet të lidhet drejtpërdrejtë me rezultatin për kompetencë.

Pas përmbylljes së aktiviteteve ditore, edukatorja/i duhet t'i kthehet edhe njëherë të gjitha veprimtarive të cilat janë zhvilluar atë ditë me fëmijët dhe të bëjë një reflektim se çfarë ishte e suksesshme atë ditë, cilat ishin pjesët e reja që fëmijët kanë arritur t'i përvetësojnë, cilat ishin sfidat në të cilën edukatorja/i apo fëmijët kishin kaluar etj. Një reflektim i tillë është dëshmuar shumë efikas në mënyrën se si edukatorja/i e avanson punën me fëmijë si dhe kjo do të jetë një ndihmë për planifikimet e radhës.

Reflektimet e tilla gjithashtu ndihmojnë për të identifikuar interesat e veçanta të fëmijëve dhe për të intervenuar në situata të caktuara.<sup>19</sup>

Përgjatë planifikimit të veprimtarive edukative me fëmijët, edukatorët inkurajohen të ndjekin hapat në vazhdim, përmes së cilëve ato do të kenë mundësi që të reflektojnë mbi njohuritë të cilat ato posedojnë në raport me zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve, planifikojnë ambientin, qasjet pedagogjike, mënyrën se si do të vlerësojnë të arriturat tek fëmijët, analizojnë dhe sqarojnë se si do t'i qasen fëmijëve për të stimuluar të nxënit tek ta, për të pasur mundësi që të veprojnë drejtë dhe arrijnë të mbështesin zhvillimin dhe edukimin e drejtë tek fëmijët. Për më shumë, edukatorët pritet që të reflektojnë mbi

---

<sup>19</sup> Forma e planeve vjetore, mujore dhe javore do të paraqitet në "Udhëzuesin për zbatimin e KB 0-5 vjeç", që do të pasoj pas këtij dokumenti.

praktikat e tyre të punës, për të pasur mundësi që ti avancojnë ato në mënyrë të vazhdueshme. *Shih tabelën në vijim, për më shumë hollësi.*

<p><b>Reflekto<sup>20</sup></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Reflekto duke përdorur njohuritë tuaja profesionale, të cilat përshijnë njohuri për secilin fëmijë, familje, pikat e forta të tyre dhe interesat;</li> <li>• Mendo se cilat janë prioritetet e institucionit tuaj të edukimit, dhe të komunitetit ku ju jetoni dhe veproni;</li> <li>• Përcaktohuni dhe argumentoni këto dëshmi;</li> </ul>	<p><b>Planifiko</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planifiko për të stimuluar të nxënit tek fëmijët, duke u bazuar në rezultatet e të nxënit;</li> <li>• Planifiko ambientin e të nxënit dhe strategjitë e mësimdhënies duke reflektuar mbi principet/ parimeve teorike dhe duke përdorur çasjet metodologjike/pedagogjike.</li> <li>• Strukturo ambientin fizik</li> <li>• Planifiko mënyrat se si do t'i monitorini dhe do t'i vlerësoni të arriturat tek fëmijët;</li> </ul>
<p><b>Analizo/Pyet/ Hulumto:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Se si mund të përdoni të mësuarit e mëparshëm të fëmijëve, interesat dhe pikat e forta të tyre për të arritur rezultatet e të nxënit dhe për të planifikuar aktivitetet edukative;</li> <li>• Mendo se si mund të punoni në partneritet me familjet për të planifikuar edukimin e fëmijëve?</li> <li>• Si mund t'i angazhoni fëmijët në mësim?</li> <li>• Cilat janë strategjitë/praktikat e përshtatshme të cilat planifikoni t'i përdorni?</li> <li>• A janë pritjet që të gjithë fëmijët të jenë të suksesshëm?</li> </ul>	<p><b>Vepra:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sigurohu se keni ndërveprim të mjaftueshëm dhe reciprok me të gjithë fëmijët, dhe se të gjithë janë duke u ndjerë të respektuar;</li> </ul>

<sup>20</sup> Adaptuar nga (CSU). Early Years Learning Framework Consortium, 2009

- Çfarë çasje / mënyra do të vëni në funksion për t'u siguruar se të gjithë fëmijët do të jenë të barabartë, dhe se secili fëmijët do të arrijë rezultatet e të nxënit?

**Reflekto:**

- Çfarë po funksionon dhe çfarë mund të përmirësohet edhe më tutje?
- Nëse të gjithë fëmijët janë duke u trajtuar në mënyrë të barabartë, ose cilat grupe të fëmijëve janë të privilegjuar ose të paforizuar nga programi ynë edukativ?
- Çfarë mënyra mund të përdorni për të preventuar trajtimin jo të barabartë?
- Në çfarë mënyra jeni duke e vlerësuar të nxënit e fëmijëve, dhe se si mund të zgjerohen ato?
- Si janë të përfshirë fëmijët dhe familjet në procesin e vlerësimit?
- Si po i ndani/ dokumentoni të arriturat tek fëmijët me prindërit dhe të tjerët?

**Vëmendje!**

*Planifikimi ditor, nuk bëhet vetëm për aktivitetin kryesor në të cilën duhet ta zhvillojë edukatorja/i për 10-15 min gjatë ditës, por edukatorja/i duhet të planifikojë se si ta bëjë ndërlidhjen e temës ditore me të gjitha veprimtaritë të cilët fëmijët kalojnë (që nga ardhja e tyre në kopsht e deri sa të shkojnë në shtëpi).*

*P.Sh temat duhet të reflektojnë në mënyrën se si ambienti duhet të jetë i rregulluar, në mënyrën se si janë të ekspozuara mjetet dhe materialet që do të përdoren, në mënyrën se me çfarë çasje metodologjike është përcaktuar të punohet me fëmijët.*

*Në këtë mënyrë mjedisi (i brendshëm dhe i jashtëm) do të jetë vazhdimisht me risi të reja (qoftë edhe me nga një element të ri), të cilat duhet të ndërlidhen ngushtë me temat dhe aktivitetet ditore, duke shmangur monotoninë që mund të sjellë imazhi i njejtë i mjedisit brenda dhe jasht institucioneve parashkollore.*



## Vlerësimi

Përgjatë fazave të para, fëmijët zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, në fusha të ndryshme zhvillimore, përfshirë shëndetin fizik dhe zhvillimin lëvizor, njohës, gjuhësor dhe psikosocial. Përgjatë kësaj periudhe, fëmija zhvillon edhe qasjen ndaj të nxënimit të përgjithshëm. Të dhënat për fushat zhvillimore dhe standardet e zhvillimit për fëmijërinë e hershme, përmes së cilave përshkruhen pritshmëritë për sjelljet e fëmijëve, dhe arritshmërinë e tyre në fusha të ndryshme të zhvillimit dhe të mësuarit është me rëndësi të jenë të njohura dhe t'i shërbejnë personelit edukativ në përshtatjen e veprimtarive edukative me fëmijët, me synim arritjen e standardeve maksimale të zhvillimit sipas grup moshës së tyre dhe të vlerësojë matjen e të arriturave<sup>21</sup>.

Për të qenë të sigurt që fëmijët janë duke përfituar nga aktivitetet edukative të planifikuara, edukatorët duhet që të krijojnë një sistem të vlerësimit të fëmijëve në periudha të ndryshme.

Gjatë vlerësimit të fëmijëve është shumë e rëndësishme të kushtohet vëmendje në: Përshkrimin e aftësive funksionale-çfarë fëmija është i aftë të konceptoj, identifikimi i nevojave të fëmijëve-çfarë duhet edukatorja të veproj që të plotësoj nevojat e fëmijëve, planifikimi se si të arrihet zhvillimi i fëmijës-çfarë të planifikohet që fëmija të arrijë rezultatet e parapara (Bergen, 1994).

Ekzistojnë hapa të caktuar të cilat edukatorja/i duhet të ndërmarrë për të bërë vlerësimin e fëmijëve. Kryesisht vlerësimi realizohet përmes vëzhgimit. Përcjellja e qëllimshme e fëmijëve (vëzhgimi), i mundëson edukatorëve të identifikojnë të arriturat e tyre të cilat i shfaqin gjatë lojës, gjatë ndërveprimit të fëmijës me fëmijë të tjerë, gjatë shpërfaqjes së sjelljes, njohurive si dhe qasjen e tyre në raport me vetveten dhe të tjerët.

---

<sup>21</sup> Për më shumë në raport me fushat e ndryshme të zhvillimit, ju mund të lexoni (Masht, 2011). Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme. Shkarkuar nga: [https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf)

Vëzhgimi i qëllimshëm i fëmijës, edukatores i mundëson të mbledh informacione rreth të arriturave të fëmijëve për fusha dhe kompetenca të parapara me Kornizën dhe kurrikulën bërthamë të grup-moshave 0-5 vjeç.

Edukatorja/i për të bërë vlerësimin e mirëfilltë duhet të ketë parasysh parimet e caktuara siç janë:

- Vlerësimi duhet të ndihmoj fëmijën në zhvillim dhe edukim të mëtejshëm
- Vlerësimi duhet të jetë në përputhje me moshën e fëmijëve si në përmbajtje (çfarë vlerëson) ashtu edhe në mënyrën e mbledhjes së të dhënave (si e vlerëson)
- Vlerësimi duhet të jetë gjuhësisht i përshtatshëm, duhet të jetë konkret dhe i qartë në përputhje me moshën e fëmijëve (cilin rezultat e vlerësoni).
- Prindërit duhet të jenë pjesë e vlerësimit të fëmijëve, jo vetëm në dhënien e informatave por edhe në pranimin e tyre nga edukatorja/i.
- Vlerësimi përmes vëzhgimit mund të realizohet përmes:
  - *listave të kontrollit (check list)*- varësisht nga fusha që dëshiron të vëzhgoj, edukatorja duhet të hartoj një listë të kontrollit duke u bazuar në rezultatet që janë të përcaktuara për kompetenca.<sup>22</sup>
  - *vëzhgimit të kohëpaskohshëm*- përmes së cilës teknikë bëhet përcjellja e një fëmije gjatë intervaleve të caktuara kohore çdo 10-15 minuta dhe mbahen shënime narrative për të.
  - *vëzhgimit të vazhdueshëm (tracking observations)*- përcjell zgjedhjet e fëmijëve brenda mjedisit, kohën si fëmijët shpenzojnë në aktivitet dhe mes aktiviteteve, se si fëmija u angazhua në aktivitet etj. Shënimet mund të mbahen në formë narrative përmes përshkrimeve të shkurtëra.
  - poashtu edukatorët mund të përdorin edhe teknika të tjera vëzhguese sikurse *shënimet anekdotike*<sup>23</sup>, *protokolin e vëzhgimit*, *vëzhgimi i një fëmije të vetëm (studim rasti)*, etj.

<sup>22</sup> Forma e listave të kontrollit (check list), do të paraqitet në “Udhëzuesin për zbatimin e KB 0-5 vjeç”, që do të pasoj pas këtij dokumenti.

<sup>23</sup> Shënimet anekdotike janë shënime të mbledhura nga edukatoria në mënyrë jo formale gjatë punës së përditëshme me fëmijë. Psh nëse fëmija flet një fjalë të re edukatoria shënon fjalën, i vendos datën dhe një mbishkrim mbi atë si

- Edukatorja/i duhet të përcaktoj kohën dhe fushën në të cilën dëshiroj të vlerësoj fëmijën.
- Ai/ajo mund të përdorë format të ndryshme vëzhgimi për të arritur gjerë në një vlerësim përmbledhës për fëmijën.
- Vlerësimi i fëmijës nuk mund të përcaktohet vetëm përmes një vëzhgimi, por duhet të realizohet disa herë në periudha të ndryshme. Në moshën 0-3 vjeç për shkak të ndryshimeve të shpejta të cilat shfaqen tek fëmijët preferohet të bëhet vlerësimi të paktën dy deri në tre here gjatë një viti. Ndërsa tek fëmijët e grup-moshave 3-5 vjeç vlerësimi rekomandohet të bëhet të paktën dy herë gjatë një viti.
- Përveç vëzhgimeve dhe mbledhjes së informacioneve përmes listave të kontrollit, edukatorja/i mund të mbledh informacione edhe përmes punës praktike që fëmijët realizojnë (vizatime, konstruktive, aktrim, etj). Të gjitha këto aktivitete mund të dëshmohen dhe të vendosen në portfolion e fëmijëve.
- Portfolio duhet të shërbejë si burim shumë i rëndësishëm, në të cilën përmban dëshmi nga puna praktike e fëmijëve si dhe listat e kontrollit të cilat janë të plotësuara nga vet edukatorja.
- Për fëmijët me nevoja të veçanta apo me talente të veçanta, edukatorja në bashkëpunim me ekspertë të tjerë, duhet të planifikoj planin individual të fëmijës si dhe vlerësimin për këta fëmijë duhet ta realizoj bazuar në këto planifikime.
- Vlerësimet eventuale profesionale<sup>24</sup>, të arriturat e fëmijëve, të dhënat nga vëzhgimet, të dhënat e tjera specifike për shëndetin e fëmijës, duhet të mbahen të sigurta, të mbrohet konfidencialiteti i fëmijës, dhe të përdoren vetëm për qëllime profesionale, të edukimit, kujdesit dhe për të mirën e fëmijës. Edukatorët dhe institucionet parashkollore, duhet të kenë rregullore të veçantë në kuadër të së cilave specifikohen çështjet etike të punës.

---

ndodhi ky shënim futet në portfolion e fëmijës. Mund të përdoret në situata të ndryshme për të mbajtur shënim për aspekte të veçanta të zhvillimit dhe të nxënies të fëmijës.

<sup>24</sup> raporte vlerësuese të cilat realizohen nga profesionist të shëndetit mendor ose profesionist shëndetësor, të cilat dorezohen nga prindërit për fëmijën e tyre.

## KAPITULLI VI

### Bashkëpunimi me familjen

Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin është domosdoshmëri në fushën e edukimit parashkollor përfshirë këtu të gjitha grup-moshat pa përjashtim. Secila nga qasjet metodologjike kërkon bashkëveprimin e vazhdueshëm me prindërit dhe komunitetin në mënyrë që fëmijës t'i mundësohet një zhvillim holistik ku te dyja palët si familja ashtu edhe institucioni bashkërendojnë aktivitetet në funksion të mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijës.

Bashkëpunimi me prindërit në institucionit parashkollor fillon qysh në momentin kur prindërit vendosin ta sjellin fëmijën e tyre në institucion. Që nga ai moment prindërit janë pjesë e pandashme e të gjithë veprimtarisë që zhvillohet në institucion prej nivelit të vendimmarrjes gjerë në nivelet më të thjeshta të përfshirjes.

Sipas Keyes (2000) përfshirja e prindërve mund të jetë e formave dhe mënyrave të ndryshme por për ta arritur këtë gjithçka duhet të fillojë nga komunikimi. Edukatorët mund të shfrytëzojnë rrugë të ndryshme për të siguruar një komunikimi të vazhdueshëm me prindërit. Ai/ajo mund të përdorë format të ndryshme të komunikimit me qëllim që të arrihet deri tek bashkëpunimi apo përciellja e porosisë. Disa nga format që mund të përdoren janë<sup>25</sup>:

- Komunikimi gjatë lënies dhe marrjes së fëmijëve nga institucioni
- Komunikimi përmes bllokut të shënimeve
- Komunikimi përmes tabelës së buletineve
- Komunikimi përmes letrave informuese
- Komunikimi përmes përdorimit të teknologjisë (telefon, email, web-faqe, etj)
- Inkurajimi i prindërve për pjesëmarrje në grupin edukativ etj.

---

<sup>25</sup> Përkunder se në vazhdim prezantohen disa forma të komunikimit dhe bashkëpunimit me prindërit, kjo nuk nënkupton se institucioni duhet të përdorë të gjitha këto alternativa. Mënyra e informimit, forma e realizimit të takimeve me prindërit, dhe format e veçanta të bashkëpunimit, është me rëndësi të përcaktohen nga rregulloret e institucionit, për të cilat informohen prindërit që nga fillimi i bashkëpunimit.

- Takimet individuale [të inicuar nga edukatori/ja ose prindërit]
- Mbledhjet me prindër

Shpeshherë në praktikën insitucionale këto forma të komunikimit i gjejmë të ndërlidhura njëra me tjetrën duke u përpjekur që të gjenden format më të mira të komunikimit dhe bashkëpunimit të cilat i përgjigjen nevojave që ka secila familje. Në rrugën drejt krijimit të një bashkëpunimi të qëndrueshëm në mes të familjes dhe institucionit parashkollor edukatori/ja duhet të jetë e përkushtuar dhe këmbëngulëse në realizimin e bashkëpunimit me qëllimin e vetëm, interesin më të lartë të fëmijës.

Hapi i parë për të krijuar një bashkëpunim të qëndrueshëm është krijimi i një klime të mirë për komunikim të efektshëm me prindërit. Përmes një komunikimi efektiv mund të arrijmë që prindërit të jenë prezent në jetën insitucionale por dhe anasjelltas, prindërit t'i shohin edukatorët/et si profesioniste të fushës dhe të ndërtojnë raporte reciproke me ata/ato. Nga komunikimi efektiv në mes të te dyja palëve, përfituesit më të mëdhenjë janë fëmijët të cilët ndjejnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë kur dy palët, prindërit dhe edukatorët, mbajnë qëndrime të njëjta për të njëjtat gjëra. Përmes skemës së paraqitur mund të shohim fushat në të cilat mund të zë vend bashkëpunimi në mes të institucionit parashkollor dhe familjes, apo thënë në mënyrë më të afërt bashkëpunimi i prindërve me edukatorën.




Figura.1. Modeli teorik mbi bashkëpunimin në mes të prindërve dhe edukatorëve

Në secilën fushë të bashkëpunimit prindërit dhe edukatorët janë partner për të cilët mirëqenia e fëmijës është pika qendrore.

- Takimet individuale [të inicuar nga edukatori/ja ose prindërit]
- Mbledhjet me prindër

Shpeshherë në praktikën insitucionale këto forma të komunikimit i gjejmë të ndërlidhura njëra me tjetrën duke u përpjekur që të gjenden format më të mira të komunikimit dhe bashkëpunimit të cilat i përgjigjen nevojave që ka secila familje. Në rrugën drejt krijimit të një bashkëpunimi të qëndrueshëm në mes të familjes dhe institucionit parashkollor edukatori/ja duhet të jetë e përkushtuar dhe këmbëngulëse në realizimin e bashkëpunimit me qëllimin e vetëm, interesin më të lartë të fëmijës.

Hapi i parë për të krijuar një bashkëpunim të qëndrueshëm është krijimi i një klime të mirë për komunikim të efektshëm me prindërit. Përmes një komunikimi efektiv mund të arrijmë që prindërit të jenë prezent në jetën insitucionale por dhe anasjelltas, prindërit t'i shohin edukatorët/et si profesioniste të fushës dhe të ndërtojnë raporte reciproke me ata/ato. Nga komunikimi efektiv në mes të te dyja palëve, përfituesit më të mëdhenjë janë fëmijët të cilët ndjejnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë kur dy palët, prindërit dhe edukatorët, mbajnë qëndrime të njëjta për të njëjtat gjëra. Përmes skemës së paraqitur mund të shohim fushat në të cilat mund të zë vend bashkëpunimi në mes të institucionit parashkollor dhe familjes, apo thënë në mënyrë më të afërt bashkëpunimi i prindërve me edukatorën.




Figura.1. Modeli teorik mbi bashkëpunimin në mes të prindërve dhe edukatorëve

Në secilën fushë të bashkëpunimit prindërit dhe edukatorët janë partner për të cilët mirëqenia e fëmijës është pika qendrore.

Edukatorët dhe anëtarët e tjerë të stafit të institucionit duhet të tregojnë kujdes për ndryshimet kulturore dhe diferencat gjuhësore të fëmijëve dhe familjarëve të tyre. Afirmimi dhe mbështetja e diversitetit na bënë të kuptojmë dhe respektojmë ndryshueshmëritë përgjatë përkujdesjes për fëmijët, të ushqyerit, të nxënimit dhe proceseve të tjera.

Për një komunikim efektiv dhe bashkëpunim të qëndrueshëm me prindërit edukatorët mund të:

- Sigurojnë raport në baza ditore ose javore për fëmijën<sup>26</sup>
- Informacionet e vendosura në buletin të rifreskohen vazhdimisht, ato informacione mund të trajtojnë çështje të shëndetit dhe kujdesit ndaj fëmijës, mbledhjeve apo takimeve me prindër, të ftuarit për atë periudhë në institucion, mbështetjen nga komuniteti, këshilla për prindërit etj.
- Dërgojnë letra informuese prindërve për të diskutuar kompetencat, rezultatet e të nxënimit, temat dhe aktivitetet e zhvilluara.
- Sygjerojnë prindërit që të zhvillojnë së bashku me fëmijët e tyre aktivitete që ndërlidhen me aktivitete e bëra në institucion me qëllim të zgjerimit të eksperiencës e fituar në institucion.
- Inkurajoni prindërit të ndajnë e ju informacionin për fëmijën dhe mendimin se çfarë është e rëndësishme për ta si prindër.
- Inkurajoni prindërit të vizitojnë institucionin parashkollor dhe të kalojnë kohë në grupin e fëmijëve përmes pjesëmarrjes së tyre në aktivitete të veçanta.
- Organizoni takime të përbashkëta me qëllim të plotësimit të nevojave individuale të fëmijës, duke u kujdesur për privatësinë dhe konfidencialitetin për familjen.
- Ofroni komunikim dygjuhësor në të shkruar nëse një gjë e tillë lehtëson bashkëpunimin.
- Krijoni mundësi të reja për prindërit vullnetar.
- Ndërtoni një skemë për prindërit vullnetar në mënyrë që secili të mund të kontribuojë aty ai/a jo ndihet më mirë. Përshtatur nga (Jackman, 2001)

---

<sup>26</sup> Është me rëndësi që edukatorët dhe institucionin parashkollor, në mënyrë të vazhdueshme të japin informacione të sakta, të plota dhe me kohë, në raport me aktivitetet e fëmijës, angazhimet e saj/tij, ndryshimet eventuale të vërejtura.

Përveç përfshirjes së prindërve, institucioni duhet të ndërmarr iniciativa edhe për përfshirjen e familjarëve të tjerë të fëmijës (motrat, vëllezërit, gjyshërit dhe familjarë të tjerë) dhe komunitetit në jetën institucionale. Institucioni parashkollor duhet të ndërtojë një kulturë komunikimi dhe bashkëveprimi me të gjithë pjesëtarët e komunitetit ku ai vepron.



## KAPITULLI VII

### Zhvillimi profesional i edukatoreve

Zbatimi i kurrikulës është proces përmes së cilit zbërthehen teoritë e zhvillimit dhe të edukimit në praktikë, në mënyrë spontane, por edhe të organizuar sipas çasjeve të ndryshme pedagogjike, të cilat në kombinim me informacionet e tjera të prezantuara në këtë dokument, synohet t'i ndihmojnë edukatorëve në dizajnimin e aktiviteteve edukativo-arsimore. Prandaj, kurrikula është planifikimi, i punës me fëmijë, bazuar në interesimet dhe nevojat e fëmijëve, të identifikuar sipas të rriturve (Claxton\* & Carr, 2004).

Për implementimin e suksesshëm të kësaj kurrikule, kujdesin adekuat ndaj fëmijëve dhe realizimin me sukses të punës edukative, është me rëndësi që edukatorët, dhe të gjithë akterët e tjerë të përfshirë në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve, të implementojnë praktikën më të mira, përmes së cilave fëmijëve u ipet mundësi të imagjinojnë, eksplorojnë, hulumtojnë, ndërveprojnë, zgjedhin probleme, mendojnë në mënyrë kritike, konstruktojnë dhe zhvillojnë njohuri dhe shkathtësi të reja përmes mbështetjes.

Edukatorët janë implementuesit kryesor të kurrikulës prandaj është me rëndësi që ta kuptojnë dhe të din të përshtasin punën e tyre me fëmijë, në raport me grup moshën dhe karakteristikat e tjera të fëmijëve.

Gjithashtu është rëndësi të kuptohet se implementimi i kurrikulës kërkon përkushtim dhe avancim të vazhdueshëm të njohurive profesionale të edukatorëve, në raport me qasjet pedagogjike ose metodologjitë e mësimdhënies, njohuri të avancuara në raport me zhvillimin e fëmijëve, avancimin e qasjeve për mbështetjen e drejtë të zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve dhe identifikimin e interesave të tyre; si dhe avancim të njohurive dhe shkathtësive në interpretimin dhe praktikimin e praktikave më të mira përmes së cilave stimulohet të nxënit dhe zhvillimi i drejtë i fëmijëve (Hohmann dhe Weikart, 2002).

Edukatori parashihet të ketë role të shumëfishta në sigurimin dhe mirëmbajtjen e çështjeve specifike të cilat rrjedhin nga kjo kurrikulë prandaj përgjatë këtij procesi duhet të avancojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e ndërtimit të raporteve pozitive me fëmijët dhe akterët e

tjerë të përfshirë në jetën e tyre, me synim planifikimin më të mirë të planit dhe programit përmes së cilit mbështetet zhvillimi dhe edukimi i drejtë i fëmijëve, dhe ka ndikim afatgjatë pozitivë.

Për implementimin e suksesshëm të kësaj kurrikulë, edukatorja/edukatori pritet të ketë rolë të shumëfishtë; të jenë bashkëpunues, komunikues, mbështetës, hulumtues, strateg, dëgjues, zgjidhës të problemeve, modelues, negocues, praktikues, krijues, hulumtues, vëzhgues, vlerësues, kritikë, nxënës gjatë gjithë jetës, partner profesional, zhvillues dhe implementues i kurrikulës ( ME: Trinidad & Tobago, 2006).

Për më shumë është me rëndësi që edukatorët të kenë mundësi të demonstrojnë kompetencë përgjatë planifikimit të punës me fëmijët, të kenë qasje pozitive ndaj të nxënës, dhe të jenë të gatshëm të zhvillojnë shkathtësitë dhe njohuritë e tyre profesionale në mënyrë të vazhdueshme.

Bazuar në instrumentin e zhvillimit profesional për përmirësimin e praktikave cilësore në kopshte (Tankersley, Brajkovic, & Handzar, ISSA), janë paraqitur fushat në të cilat pritet që një edukator/e të jetë kompetente dhe e zhvilluar profesionalisht: Informacionet në vijim, mund t'u shërbejnë edukatorëve që të reflektojnë mbi njohuritë dhe kompetencat e tyre, të avancojnë praktikat e tyre të punës me fëmijë përmes vetëvlerësimit, vlerësimit të ndërsjellët, por njëkohësisht mund t'u shërbejnë edhe udhëheqësve të institucioneve të edukimit të hershëm, në vlerësimin e performancës së edukatoreve dhe identifikimin e pikave të forta ose nevojave për avancimin e nivelit të njoërive ose kompetencave të personelit edukativo-arsimor.

Po ashtu, instituconet e edukimit të hershëm është me rëndësi të jenë në mënyrë të vazhdueshme të angazhuar në zhvillimi profesional të edukatorëve dhe cilësinë e edukimit të hershëm. Zhvillimi profesional i edukatorëve dhe personelit të institucioneve të edukimit të hershëm, mund të realizohet në forma të ndryshme<sup>27</sup>, përfshirë:

---

<sup>27</sup> Format e prezantuara në vijim janë vetëm disa nga alternativat të cilat janë dëshmuar të suksesshme në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të edukatorëve dhe mund t'i ndihmojnë atyre në implementimin sa më adekuat të punës edukative dhe implementimin e kurrikulës. Sidoqoftë, zhvillimi profesional i punonjësve të edukimit të hershëm, kriteret dhe kompetencat që duhet të përmbushin edukatorët të paracaktuara me akte ligjore, udhëzime administrative, janë çështje të tjera të veçanta të cilat duhet ndjekur nga institucionet edukativo arsimore.

- Përmes takime studimore brenda grupeve të personeleve edukative;
- Duke u inkurajuar zhvillimi i aftësive hulumtuese/ kërkuese;
- Përmes observimeve dhe feedback-ut;
- Takime individuale me personelin edukativ;
- Organizimit të punëtorive dhe ose ligjeratave brenda dhe jashtë institucionit;
- Pjesëmarrjeve në konferenca me synim avancimin e njohurive për çështje të ndërlidhura me edukimin e hershëm;
- Takime në mes të personelit edukativ me synim avancimin e programit edukativ, zgjedhjes së problemeve, reflektimit mbi praktikat e punës, etj;
- Krijimit të resurseve elektronike dhe ose pasurimit të bibliotekave për shkëmbimin e informacioneve në mes të personeleve edukative [literaturës, manualeve, dhe udhëzimeve të tjera shtesë në raport me rolin e edukatorit];

Figura. 3. Zhvillimi profesional i edukatorëve (ISSA)



## LITERATURA

- Bergen, D. (1994). *Assessment methods for infants and toddlers: Trans disciplinary team approaches*. New York, USA: Teachers College Press, NY.
- Blaise, M. (2005). A feminist poststructuralist study of children doing gender. *Early Childhood Research Quarterly*, 20, 85–108.
- Bronfenbrenner, U. (1967). The psychological costs of quality and equality in education. *Child Development*, 909-925.
- Brotherus, A., Hytönen, J. And Krokfors, L. (2002). *Esi-ja alkuopetuksen didaktiikka*, Porvoo: WSOY. [The didactics of preschool education; in Finnish]
- Bruner, J. S. (2006). *In Search of Pedagogy Volume I: The Selected Works of Jerome Bruner, 1957-1978*. Routledge.
- Coughlin, P. A., Hansen, K. A., Heller, D., Kaufmann, R. K., Stolberg, J. R., & Walsh, K. B. (1997). *Hap pas Hapi: Një program për fëmijët dhe familjet: Krijimi i klasave me fëmijët në epiqendër: fëmijët 3-5 vjeçarë*. Washington D.C.: Organizata Ndërkombëtare për Burimet e Fëmijëve.
- Claxton\*, G., & Carr, M. (2004). *A framework for teaching learning: the dynamics of disposition*. *Early years*, 24(1), 87-97.
- Cooper, D. E., Cooper, J. A. P., & Bresler, L. (2002). *Fifty major thinkers on education: From Confucius to Dewey*. Routledge.
- Deci, E. L., & Ryan, R. M. (2008). Self-determination theory: A macrotheory of human motivation, development, and health. *Canadian psychology/Psychologie canadienne*, 49(3), 182.
- Deci, E., & Ryan, R. M. (1985). *Intrinsic motivation and self-determination in human behavior*. Springer Science & Business Media.
- Donahoe, S. (2001). The Need for Culturally Rich Experiences as Children Learn To Read, Write, Draw, and Communicate in American Education Today.
- Edwards, S. (2003). New directions: Charting the paths for the role of socio-cultural theory in early childhood education and curriculum. *Contemporary issues in early childhood*, 4(3), 251-266.
- Elkind, D. (2001). Much too early. *Education Next*, 1(2), 9-15.
- Feez, S. (2010). *Montessori and Early Childhood: A Guide for Students*. Thousand Oaks, California: SAGE Publications.
- Gardner, H. (2006). *The development and education of the mind: The selected works of Howard Gardner*. Routledge.

- Härkönen, U. (2003). Current Theories Related to Early Childhood Education and Preschool as Frames of Reference for Sustainable Education
- Hay, D. F., Payne, A., & Chadwick, A. (2004). Peer relations in childhood. *Journal of child psychology and psychiatry*, 45(1), 84-108.
- Heylighen, F. (1992). A cognitive-systemic reconstruction of Maslow's theory of self-actualization. *Behavioral science*, 37(1), 39-58.
- Hohmann, M., & Weikart, D. P. (2002). *Educating young children. High/Scope Educational Research Foundation*. Michigan: High.
- Isaacs, B. (2010). *Bringing the Montessori Approach to your Early Years Practice* (Second Edition ed.). (S. Green, Ed.) London and New York: Routledge: Taylor & Francis Group.
- Jackman, H. L. (2001). *Early education curriculum : a child's connection to the world* (2nd ed.). United States of America: Delmar, Thomson Learning.
- Jackman, H. L. (2012). *Early Education Curriculum: A child's Connection to the World* (5th ed.). Belmont, CA: Wadsworth, Cengage Learning.
- Keyes, C. R. (2000). *Parent-Teacher Partnerships: A Theoretical Approach for Teachers*. <http://ericee.org/pubs/books/katzsym/keyes.pdf>.
- Kinney, L., & Wharton, P. (2008). *An Encounter with Reggio Emilia: Children's Early Learning Made Visible*. Abingdon, Oxon: Routledge.
- Kuvendi i Kosovës. (2006). Ligji për edukimin parashkollor Nr. 02/L-52. Prishtinë, Kosovë: MASHT.
- Macnaughton, G., & Smith, K. (2005). Transforming research ethics: The choices and challenges of researching with children.
- Mato, E., & Kamani, P. (2000). *Në kërkim të njohjes*. Tiranë: -.
- MASHT. (2016, Korrik). Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021. Prishtinë, Kosovë.
- MASHT (2011). Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e Hershme. Shkarkuar nga: [https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-ëeb\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-ëeb_1.pdf)
- MASHT. (2018, Dhjetor). <https://masht.rks-gov.net>. Retrieved from <https://masht.rks-gov.net:https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
- MASHT. (2016). *Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Prishtinë: MASHT.
- Ministry of Education ( 2006). *Early childhood care and education curriculum guide*: Ministry of Education, Trinidad & Tobago.

- Mawson, W. B. (2010). *Collaborative play in early childhood education*. New York: Nova Science Publishers, Inc.
- Monteiro, T. (2005). Rousseau's Concept of Education.
- Mooney, C. G. (2013). *Theories of childhood: An introduction to Deëey, Montessori, Erikson, Piaget and Vygotsky* (Second Edition ed.). St.Paul, MN: Redleaf Press.
- Morrison, G. S. (1988). *Early childhood education today*. Columbus, Ohio: Merrill Publishing Company.
- Peltzman, B. R. (1998). *Pioneers of Early Childhood Education: A Bio-Bibliographical Guide*. Greenwood Publishing Group, 88 Post Road West, Box 5007, Westport, CT 06881.
- RKS, Q. e. (2016, Janar). Strategjia Kombetare e zhvillimit 2016-2021. Prishtine, Kosove.
- Rhedding-Jones, J. E. A. N. E. T. T. E. (2003). Feminist methodologies and research for early childhood literacies. *Handbook of Early Childhood Literacy, London, Thousand Oaks and Neë Delhi: SAGE*, 400-410.
- Rubin, K. H., Bukowski, E. M., Parker, J. G., & Bowker, J. C. (2008). Peer interactions, relationships, and groups. *Child and adolescent development: An advanced course*, 141-180.
- Smith, A. B. (1993). Early childhood educare: Seeking a theoretical framework in Vygotsky's work. *International Journal of Early Years Education*, 1(1), 47-62.
- Stephen, C. (2012). Looking for theory in preschool education. *Studies in Philosophy and Education*, 31(3), 227-238.
- Szanton, E. S., & Coughlin, P. A. (1997). *Krijimi i programeve me fëmijën në epiqendër për foshnja dhe fëmijë 2-3 vjeç*. Tiranë : UNICEF.
- Tankersley, D., Brajkovic, S., & Handzar, S. (ISSA). *Instrumenti i zhvillimit profesional për përmirësimin e praktikave cilësore në kopshte*. International Step by Step Association.
- Thornton, L., & Brunton, P. (2010). *Bringing the Reggio Approach to your Early Years Practice* (2nd ed.). (S. Green, Ed.) Oxon: Routledge Taylor & Francis Group.
- UNESCO. (2006). *Education for All Global Monitoring Report: Strong Foundations Early Childhood Education* (Second revised edition ed.). Paris: UNESCO Publishing.
- UNESCO. (2019, Qershor). <https://en.unesco.org>. Retrieved from <https://en.unesco.org/themes/early-childhood-care-and-education>
- World Forum Foundation. (2014). [worldforumfoundation.org/curriculum](http://worldforumfoundation.org/curriculum). Retrieved from [worldforumfoundation.org/curriculum](http://worldforumfoundation.org/curriculum): <https://worldforumfoundation.org/wp-content/uploads/2018/06/Universal-Curriculum-Principles-2014.pdf>

Whitebread, D., Kuvalja, M., & O'Connor, A. (2014). *Quality in early childhood education: An international review and guide for policy makers*. Qatar Foundation.

Zilversmit, A. (1993). *Changing Schools: Progressive Education Theory and Practice, 1930-1960*. University of Chicago Press, Book Orders, 5801 South Ellis Avenue, Chicago, IL 60637-1496 (cloth--ISBN-0-226-98329-3)..